BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STATISTIKAVE FINANCIARE

NJOFTIM STATISTIKOR
BORXHI I JASHTËM BRUTO

TI-2018

11 Qershor, 2018

Përmbajtja

Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve 2

Borxhi i jashtëm bruto sipas instrumenteve 3

Borxhi i jashtëm bruto sipas maturitetit 3

Borxhi i jashtëm bruto sipas monedhës 3

Tërheqjet e borxhit të jashtëm bruto 4

Shërbimet e borxhit të jashtëm bruto 4

Shënime metodologjike 6

Kryesore:

- Borxhi i jashtëm bruto vlerësohet në 7,906 milionë euro;
- 77% e vëllimit të borxhit të jashtëm bruto është borxh afat-gjatë;
- Në masën 46% borxhi i tërhequr i përket Sektorit Bankar.

BORXHI I JASHTËM BRUTO

Në fund të muajit mars të vitit 2018 Borxhi i Jashtëm Bruto (BJB) i Shqipërisë shënoi rreth 7,906 milionë euro. Gjatë tremujorit të parë të vitit, stoku i BJB u zvogëlua me rreth 22 milionë euro, ndërsa ngushtimi vjetor shënon 72 milionë euro.

Në rreth 77% të vëllimit BJB është në trajtën e borxhit afatgjatë - kryesisht në formën e huave të zotëruara nga *Qeveria e Përgjithshme*. Borxhi afatshkurtër zotërohet kryesisht nga *Bankat*.

Qeveria e Përgjithshme zotëron pjesën kryesore të BJB, me rreth 44% të totalit. Pjesa tjetër është e shpërndarë midis *Bankave* (17%), *Sektorëve të tjerë* (16%), *Autoritetit monetar* (1%) dhe hua midis kompanive të lidhura në një marrëdhënie *investimi direkt* (21%).

Në milionë euro	Mars2017	Qershor 2017	Shtator 2017	Dhjetor 2017	Mars 2018
1. Qeveria e përgjithshme	**3,478**	**3,400**	**3,431**	**3,529**	**3,509**
1.1 Afatshkurtër	-	-	-	-	-
1.2 Afatgjatë	3,478	3,400	3,431	3,529	3,509
2. Autoriteti monetar	**62**	**59**	**57**	**57**	**56**
2.1 Afatshkurtër	-	-	-	-	-
2.2 Afatgjatë	62	59	57	57	56
3. Bankat	**1,363**	**1,356**	**1,362**	**1,386**	**1,381**
3.1 Afatshkurtër	1,238	1,231	1,238	1,230	1,239
3.2 Afatgjatë	125	125	124	156	142
4. Sektorë të tjerë	**1,306**	**1,293**	**1,257**	**1,241**	**1,273**
4.1 Afatshkurtër	364	371	351	350	376
4.2 Afatgjatë	941	921	906	891	898
5. Investime direkte - hua ndërk-	**1,769**	**1,748**	**1,728**	**1,715**	**1,687**
Borxhi i jashtëm bruto	**7,978**	**7,856**	**7,835**	**7,928**	**7,906**

Tabela 1: Stoku i Borxhit të Jashtëm Bruto.

BORXHI I JASHTËM BRUTO SIPAS SEKTORËVE

Sektori i *Qeverisë së Përgjithshme* mban peshën kryesore në stokun e BJB-së. Në harkun kohor të një viti, borxhi i jashtëm i këtij sektori është zgjeruar me 31 milionë euro dhe në fund të muajit mars 2018 shënon 3,509 milionë euro. Detyrimet e *Qeverisë së Përgjithshme* prezantohen kryesisht si hua afatgjata, obligacione dhe dëftesa. Në terma vjetorë, teprica e huave afatgjata u zgjerua me rreth 28 milionë euro, ndërsa ajo e obligacioneve me 3 milionë euro.

Gjatë periudhës (tremujori i parë 2018) borxhi i jashtëm i *Qeverisë së Përgjithshme* ra me rreth 20 milionë euro, në drejtim të shlyerjes së detyrimeve të huave afatgjata.

Huatë e *Qeverisë së Përgjithshme* përfaqësohen nga huatë e tërhequra pas viteve '90 dhe ato të riskeduluara, të cilat vazhdojnë të jenë të negociueshme midis palëve. Në fund të periudhës, huatë e riskeduluara përfaqësonin 0.5% të stokut të huave afatgjata të këtij sektori.

Stoku i borxhit të *Autoritetit Monetar* ose Bankës së Shqipërisë, ra përgjatë vitit me rreth 10%, në reflektim të zvogëlimit të alokimeve në SDR dhe të huave afat-gjata dhe në fund të muajit mars 2018 shënon 56 milionë euro. Tremujori i parë 2018, nuk shënoi levizje të konsiderueshme në nivelin e borxhit të këtij sektori. Në masën më të madhe, detyrimet e *Autoritetit Monetar* përbëhen nga alokimet e SDR-së (98%), ndërsa huatë afatgjata të akorduara nga FMN zënë vetëm 2%.

Në fund të marsit 2018, stoku i borxhit të jashtëm bruto të *Sistemit Bankar* shënon rreth 1,381 milionë euro dhe në terma vjetorë qëndron në një nivel rreth 18 milionë euro më të lartë. Ndërkohë, gjatë tremujorit të parë 2018, ky sektor ka tkurrur nivelin e borxhit me rreth 5 milionë euro në drejtim të uljes së detyrimeve afatgjata. Borxhit i jashtëm i sektorit bankar prezantohet kryesisht në formën *"hua"* dhe *"monedha e depozita",* respektivisht në rreth 14% dhe 86% të totalit.

Sektori i Qeverisë së Përgjithshme mban peshën kryesore në stokun e BJBsë dhe shënon zgjerimin më të lartë në terma vjetorë

Referuar nivelit në fund të mars 2017, *Sektorët e Tjerë* kanë tkurrur detyrimet e tyre me jashtë, me rreth 32 milionë euro në nivelin 1,273 milionë euro. Lëvizjet kryesore reflektojnë ngushtim të detyrimeve afatgjata në formën e "huave" (-64 milionë euro) dhe në të njëjtën kohë, zgjerim të detyrimeve afatshkurtra në formën e "kredive tregtare" (23 milionë euro).

Borxhi i jashtëm i krijuar në formën e huave midis kompanive të lidhura në një marrëdhënie *investimi direkt* ra si në terma vjetorë ashtu edhe gjatë periudhës, kryesisht si pasojë e shlyerjes së detyrimeve.



Grafik 1: Stoku i Borxhit të Jashtëm Bruto sipas sektorëve

BORXHI I JASHTËM BRUTO SIPAS INSTRUMENTEVE

Nga pikëpamja e instrumenteve financiarë, akumulimi i borxhit të jashtëm vijon i përqendruar në formën e *"investimeve të tjera"* (në rreth 71% të totalit), kryesisht *"hua"*. Ndërkohë, *"Investimet direkte"* – shprehur në formën e huave midis kompanive të lidhura - dhe *"investimet e portofolit"* përfaqësojnë së bashku rreth 29% të totalit të borxhit të jashtëm.

Në harkun kohor të një viti, stoku i borxhit në formën e *"huasë" ra* me 7 milionë euro dhe në fund të muajit mars 2018 shënon 4,019 milionë euro. Në të njëjtën kohë, janë zgjjeruar detyrimet në formën e *"kredive tregtare"* respektivisht me 23 milionë euro dhe kanë rënë "detyrimet e tjera" me 20 milionë euro.

Në milionë euro	Mars 2017	Qershor 2017	Shtator 2017	Dhjetor 2017	Mars 2018
Borxhi i jashtëm bruto	**7,978**	**7,856**	**7,835**	**7,928**	**7,906**
Investime direkte	1,769	1,748	1,728	1,715	1,687
Investime portofoli	578	584	584	587	590
Investime të tjera	5,631	5,524	5,524	5,626	5,629
Hua	*4,026*	*3,924*	*3,928*	*4,021*	*4,019*
Monedha dhe depozita	*1,180*	*1,182*	*1,185*	*1,201*	*1,182*
Kredi tregtare	*345*	*355*	*336*	*342*	*368*
Të tjera	*80*	*64*	*75*	*62*	*61*

Tabela 2: Borxhi i jashtëm bruto sipas instrumenteve

Stoku i borxhit të jashtëm është i përqëndruar në formën e investimeve të tjera - kryesisht hua dhe monedha e depozita

BORXHI I JASHTËM BRUTO SIPAS MATURITETIT

Në fund të marsit 2018, borxhi afatgjatë i Shqipërisë arriti në 6,073 milionë euro dhe përfaqëson 77% të totalit të borxhit. Në harkun kohor të një viti, borxhi afatgjatë u zvogëlua me 90 milionë euro. Rreth 58% e stokut të borxhit afatgjatë zotërohet nga sektori i *Qeverisë së Përgjithshme*, i ndjekur nga *Investime Direkte* – hua ndër kompani (rreth 24%) dhe *Sektorë të Tjerë* (rreth 15%).

Në fund të periudhës, borxhi afatshkurtër shënoi rreth 1,832 milionë euro dhe në terma vjetorë u zgjerua me 18 milionë euro.

Sektori i *Qeverisë së Përgjithshme* dhe ai i *Autoritetit Monetar* zotërojnë vetëm borxh afatgjatë.

BORXHI I JASHTËM BRUTO SIPAS MONEDHËS

Monedha evropiane (EUR) është monedha kryesore në emërimin e detyrimeve të Shqipërisë ndaj botës, me rreth 65% të totalit në fund të periudhës.



Grafik 2. Struktura e BJB sipas monedhave në Mars 2018

TËRHEQJET E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO

Totali i tërheqjeve ose fluksi i borxhit të ri gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, ishte 59.9 milionë euro (Shih Tabela 3). Tërheqjet e sektorit publik shënojnë 23.7 milionë euro dhe ato të sektorit privat 36.3 milionë euro. Struktura e tërheqjeve përbëhet kryesisht nga detyrime të reja borxhi të *Sektorit Bankar* (në masën 46%) dhe të *Qeverisë së Përgjithshme* (në masën 40%).

Në milionë euro	**T2 2017**	**T3 2017**	**T4 2017**	**T1 2018**
1. Sektori publik				
Tërheqje	62.6	105.9	162.1	23.7
Pagesa principali	73.3	40.7	53.8	28.8
Pagesa interesi	12.3	13	12.9	14.8
2. Sektori privat				
Tërheqje	22.4	15.1	33.5	36.3
Pagesa principali	27.3	51.9	29.1	19.8
Pagesa interesi	2	2.4	2.4	2.7
Gjithsej (Ekonomia)				
Tërheqje	85	121	195.6	59.9
Pagesa principali	100.6	92.6	82.9	48.7
Pagesa interesi	14.3	15.4	15.3	17.5

Tabela 3: Tërheqjet dhe shërbimi i borxhit nga sektori publik dhe sektori privat
Shënim: në sektorin publik përfshihen Qeveria e Përgjithshme dhe Autoriteti Monetar

Rreth 46% vlerës së borxhit të tërhequr gjatë periudhës i përket Sektorit Bankar.

SHËRBIMET E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO

Shërbimi i borxhit të jashtëm (pagesat e principalit dhe të interesit) për tremujorin e parë 2018 shënon 66.1 milionë euro. Nga këto, rreth 37.1 milionë euro janë pagesa të *Qeverisë së Përgjithshme*, 16.9 milionë euro të *Sektorëve të Tjerë,* 11.1 milionë euro të *Sistemit Bankar* dhe 1 milionë euro të *Autoritetit Monetar.*

Në masën 74%, shërbimi i borxhit ka qenë për shlyerje të kryegjësë (principalit) dhe në 26% për shlyerjen e interesave.

Qeveria e Përgjithshme mban peshën kryesore në shlyerjet e principalit dhe të interesit për periudhën, me rreth 23 milionë euro ose 48% të vlerës së përgjithshme të principalit, si dhe rreth 14 milionë euro ose 80% të vlerës së përgjithshme të interesave të paguara nga ekonomia.

Në milionë euro	T2 2017	T3 2017	T4 2017	T1 2018
1. Qeveria e përgjithshme	77.1	46.5	58	37.1
2. Autoriteti monetar	0.8	1.4	0.5	1.0
3. Bankat	13.1	18.5	6.7	11.1
4. Sektorë të tjerë	23.9	41.5	33	16.9
Shërbimi total i borxhit	**114.9**	**108.0**	**98.3**	**66.1**

Tabela 4: Shërbimi i borxhit ë jashtëm bruto sipas sektorëve



Grafik 3: Shërbimi i borxhit ndaj stokut të borxhit sipas sektorëve (%)

Qeveria e Përgjithshme mban peshën kryesore në shlyerjet e pagesave të principalit dhe të interesit

SHËNIME SHPJEGUESE

Hyrje	Të dhënat e paraqitura i përkasin stokut të fundit të periudhës të detyrimeve të huaja financiare të ekonomisë shqiptare. Të dhënat janë kompiluar në bazë bruto: d.m.th ato nuk iu përkasin zotërimeve të rezidentëve të Shqipërisë në mjete të huaja, gjë që është thelbësore. Ashtu si statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare dhe statistikat e Borxhit të Jashtëm bëjnë dallimin ndërmjet investimeve direkte, investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera dhe përsërisin në një detajim më të gjërë anën e detyrimeve të paraqitjes vjetore të PIN-t. Si e tillë, tabela e Borxhit të Jashtëm identifikon atë element të bilancit të agreguar të Shqipërisë që tregon detyrimet financiare bruto (detyrimet) të rezidentëve të Shqipërisë ndaj jo-rezidentëve me përjashtim të titujve të kapitalit dhe derivativëve. Shifrat prezantohen në mënyrë që të kenë qëndrueshmëri me formatet e prezantimit ndërkombëtar. Informacioni është bërë i disponueshëm për Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore (http://ddpext.worldbank.org/ext/ddpreports/VieëSharedReport?REPORT_ID=14141&REQUEST_TYPE=VIEËADVANCED).
Standarte Statistikore Ndërkombëtare	Statistikat e Borxhit të Jashtëm janë kompiluar në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përshkruara në "Manuali i Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Edicioni i Gjashtë" (FMN) dhe me udhëzuesin për kompilues e përdorues "Statistikat e Borxhit të Jashtëm" (FMN). Ndjekja e këtyre standardeve siguron pajtueshmëri të të dhënave nga njëra anë dhe nga ana tjetër, konsistencë midis statistikave të borxhit e atyre të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare. Të dhënat mbi borxhin e jashtëm bruto janë një burim i rëndësishëm informacioni për zëra të caktuar të këtyre statistikave (shiko më poshtë përkufizimin e *borxhit të jashtëm*).
Përkufizimi i Borxhit të Jashtëm	Guida e Borxhit të Jashtëm të FMN-së e përkufizon borxhin e jashtëm si një pikë në kohë në pasqyrën financiare të vlerës dhe përbërjes së stokut të detyrimeve financiare bruto të një ekonomie ndaj pjesës tjetër të botës. Detyrimet të cilave ju referohemi mbulojnë kreditë e marra nga jo-rezidentët, llogaritë dhe depozitat e jo-rezidentëve, kreditë tregtare që duhet tu paguajmë jo-rezidentëve si dhe detyrime të tjera ndaj tyre. Në thelb, borxhi i jashtëm iu referohet detyrimeve financiare ndaj jo-rezidentëve dhe jo atyre që rezultojnë nga transaksionet në kapital ose nga kontratat e derivativëve financiarë.
Rezidenca	Termi *rezident* iu dedikohet (a) individëve, përfshirë dhe atyre me kombësi të huaj, që jetojnë në Shqipëri për të paktën një vit ashtu si dhe stafit të ambasadës shqiptare dhe stafit ushtarak të vendosur jashtë, (b) trupave qeveritare shqiptare të vendosura jashtë (ambasadave, konsullatave, etj), dhe (c) koorporatave që kanë në Shqipëri qendrën e interesit ekonomik, përfshirë dhe degë të kompanive të huaja të regjistruara. Gjithashtu përfshihen edhe sipërmarrjet me pronësi të huaj të vendosura në Shqipëri dhe të angazhuara në aktivitete të shërbimeve financiare të tregtuara në arenën ndërkombëtare. *Jorezidentë* të një ekonomie përkufizohen njësitë institucionale që nuk janë rezidentë të asaj ekonomie.
Tipet e Instrumentave Financiarë të Rëndësishëm për Borxhin e Jashtëm	*Kapitali:* ndërkohë që, detyrimet e lindura nga pjesëmarrja me fuqi votuese në kapital (përfshirë këtu detyrimet që lindin nga emetimi i pjesëmarrjeve në institucione kolektive investimi) përjashtohen nga statistikat e borxhit të jashtëm, detyrimet që lindin si pasojë e emetimit të aksioneve preferenciale jo-pjesëmarrëse përfshihen dhe trajtohen si tituj borxhi nën zërin (afatgjatë) *obligacione dhe tituj.* *Obligacionet dhe titujt* e emetuar nga kompanitë ose qeveria janë tituj borxhi të tregtueshëm që kanë një maturitet fillestar prej më shumë se një vit, i cili, zakonisht, i jep mbajtësit (i) të drejtën e pakushtëzuar te një e ardhur monetare fikse ose te një e ardhur variable të përcaktuar kontraktualisht dhe (ii) të drejtën e pakushtëzuar te një shumë fikse në pagesat e principalit në një datë ose data specifike. *Instrumentet e tregut të parasë* janë tituj borxhi të emetuar me një maturitet fillestar prej një viti ose më pak. Ata i japin mbajtësit të drejtën e pakushtëzuar për të marrë një shumë parash të deklaruar dhe fikse në një datë specifike. Këta instrumenta janë, përgjithësisht të tregtueshëm me skonto në tregje të organizuara. Skontoja është e varur nga norma e interesit të instrumentit të lidhur me normën e interesit të tregut dhe kohën e mbetur deri në maturim. Shembuj të instrumenteve të tillë janë: bonot e thesarit, letrat tregtare dhe financiare dhe pranimet bankare.

	Kreditë tregtare (të pagueshme) janë detyrime që lindin nga zgjerimi direkt i kredisë i lidhur me transaksione në mallra dhe shërbime dhe pagesa në avancë për punën në progres (ose që duhet ndërmarrë). *Huatë/monedhat dhe depozitat* përfshijnë huatë, depozitat dhe monedhat (si p.sh, kart-monedhat dhe monedhat që janë në qarkullim dhe të përdorura gjerësisht për të kryer pagesa). Të përfshira janë huatë për të financuar tregtinë, hua të tjera dhe paradhënie (përfshirë dhe kredinë për shtëpi) ashtu si dhe lizingu financiar. Stoku i detyrimeve i gjithë instrumenteve të tjerë financiarë (ndryshe nga kapitale jo-pjesëmarrëse - pa fuqi votuese, tituj të borxhit, kredi tregtare, hua, monedha dhe depozitave), të tillë si kapitali i nënshkruar për pjesëmarrje nga Shtete Anëtare në organizatat ndërkombëtare jo-monetare, ndryshimet në rezervat teknike të sigurimit, kompensimet për sa iu përket transaksioneve të titujve të papaguar, përfshihen në *detyrime të tjera* brenda borxhit të jashtëm.
Mbledhja e të dhënave	Burim informacioni për statistikat e Borxhit të Jashtëm janë: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Organizata e Institucione të tjera Ndërkombëtare si dhe sistemi bankat pjesë e Sistemit të Unifikuar të Raportimit në Bankën e Shqipërisë.
Vlerësimi	Stoku i detyrimeve është regjistruar në vlerë nominale dhe jo në vlerë tregu dhe Borxhi i Jashtëm Bruto i Shqipërisë është kompiluar në lekë dhe raportuar në euro. Për stokun e detyrimeve në monedha të tjera, konvertimi bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit. Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit është përfshirë në vlerësimin e stokut të detyrimeve. Instrumentet përkatës përfshijnë dhe interesat e përllogaritur në vlerën e stokut të tyre.
Paraqitja e tabelës	Paraqitja e të dhënave të borxhit të jashtëm së pari dallon sektorët institucionalë: *Qeveria e Përgjithshme* – mbulon qeverinë qëndrore *Autoriteti Monetar* – është Banka Qëndrore e Shqipërisë *Korporatat depozituese me përjashtim të Bankës Qëndrore* – janë bankat e liçensuara *Sektorët e Tjerë* – janë të gjitha koorporatat e tjera dhe si dhe ekonomitë shtëpiake. Të përfshira këtu janë: kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensionit, fondet e investimit, shoqëritë e kursim kreditit, tregtarët e titujve, ashtu si dhe kompanitë e shërbimeve jo-financiare dhe të prodhimit dhe sipërmarrje të tjera industriale. Kategoria e *investimeve direkte* dallohet, gjithashtu, në këtë nivel. *Investimi direkt* është një kategori e investimit ndërkombëtar që, bazuar në një pronësi kapitali në të paktën 10%, reflekton një interes të qëndrueshëm të një rezidenti në një ekonomi (investitori direkt) në një sipërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër (kompania e investimit direkt). *Detyrimet e borxhit ndaj sipërmarrjeve të lidhura* dhe *detyrimet e borxhit ndaj investitoreve direktë* mbulojnë të gjitha detyrimet e borxhit (siç janë përcaktuar më sipër) të kompanive rezidente ndaj mëmave të tyre të huaja, degëve ose sipërmarrjeve të tjera të lidhura jashtë. Brenda sektorëve klasifikimet jepen sipas: *maturitetit - afat-shkurtër*: në rastet e një maturimi origjinal një vit ose më pak; *afat-gjatë*: për një maturim origjinal më shumë se një vit; dhe sipas, *instrumentit financiar*: monedha dhe depozita, *tituj borxhi, kredi tregtare (të pagueshme), detyrime të tjera borxhi dhe alokimet në SDR.*

DEPARTAMENTI I STATISTIKAVE FINANCIARE

Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01
+ 355 4 241 93 02
+ 355 4 241 93 03
+ 355 4 241 94 09
+ 355 4 241 94 10
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org

Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njeh përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës nuk kanë ndodhur ndryshime në stokun e borxhit të jashtëm bruto si pasojë e rishikimeve.